




REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	09.01.2024	4	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SKPM/MAKU	143/2024		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1381/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demianëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i lartë për bashkëpunim profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1381/2023 të datës 06.11.2023 të ankuesit me adresë banimi: në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.01.2024, mori këtë.

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me A.nr.1381/2023, e datës 01.11.2023, e parashtruara nga ankuesi

II.Mbetet ne fuqi Vendimi i datës 11.10.2023 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik

Arsyetim

Ankuesi (tutje referuar ankuesi), me datë 06.11.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.1381/2023, kundër Vendimit të datës 11.10.2023 të Departamentit për menaxhimin e Zyrtarëve Publik, me pretendimet ankimore se i njëjti nuk ka qenë i familjarizuar me sistemin e aplikimit online në procedurat e rekrutimit, me arsyetimin se i njëjti i plotëson dokumentacionin e kërkuar sipas konkursit të shpallur me kërkesën që t'i njihet e drejta për të vazhduar tutje në procedurën e rekrutimit për pozitën "Inspektor Farmaceutik".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 08.11.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme, (tani e tutje DMZP/MPB), ndërsa Këshilli me datë 08.11.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 06.11.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 06.11.2023 dërguar nga ankuesi për Këshillin; Vendimin e datës 11.10.2023 të DMZP/MPB-së; Vendimin e datës 03.10.2023 të DMZP/MPB-së; Licencë e punës e datës 11.11.2022; Çertifikatë e datës 03.10.2023 lëshuar nga Këshilli Gjyqësore i Kosovës; Pasqyrë e llogarisë së trustit e ankuesit; Çertifikatë e datës 23.04.2010; Çertifikatë e datës 31.10.2009; Çertifikatë e datës 03.06.2010; Çertifikatë e datës 10.09.2011; Çertifikatë e datës 23.09.2012; Çertifikatë e datës 20.10.2012; Çertifikatë e Kongresit 2 të Farmacisë; Çertifikatë e datës 15.06.2013; Çertifikatë e datës 23.04.2017; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 08.11.2023; Përgjigje në kërkesë e datës 08.11.2023; Konkursin e datës 08.09.2023; Aplikacionin e ankuesit të datës 08.09.2023; Diplomë e datës 01.06.2009; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Ankesën e ankuesit të datës 04.10.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Ministria e Punëve të Brendshme, me datë 09.08.2023, ka shpallur konkursin e jashtëm-pranim, me numër të referencës RN00012281, emri i grupit "Specialistë të farmaceutikës" pozita e punës "Inspektor Farmaceutik", Klasa "Profesional 1", numri i kërkuar tetë (8 vende pune), në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, në të cilin konkurs vërtetohet fakti se ka aplikuar edhe ankuesi më datë 14.10.2023.

Tutje, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë përmes vendimit të datës 03.10.2023 e njofton ankuesin se të njëjtit i është refuzuar aplikacioni për shkak se nuk ka bashkangjitur në momentin e aplikimit dëshmitë apo dokumentacionin e kërkuar sipas konkursit të datës 09.08.2023, ndërsa ankuesi kundër të njëjtit vendim ka parashtruar me datë 04.10.2023 ankesë të brendshme në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, ndërsa këta të fundit me datë 11.10.2023 përmes Vendimit me shifër:01/2023 e refuzojnë ankesën e ankuesit ndërsa lë në fuqi vendimin për refuzimin e aplikacionit me të njëjtën arsye se ankuesi me rastin e aplikimit në konkurs nuk ka bashkangjitur dëshmitë që lidhen me licencën e punës, dëshminë mbi përvojën e punës profesionale prej së paku 2 vite në fushën për të cilën zhvillohet përvoja e punës, certifikatën/vërtetimin e gjykatës përmes së cilës dëshmohet se ankuesi nuk i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale, vetë deklarin që i njëjti nuk ka të shqiptuar masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit dhe arsyetimit të dhënë në vendimin e goditur përmes kësaj ankesë, Kolegji i Këshillit ka analizuar konkursin e shpallur të datës 09.08.2023 për pozitën "Inspektorë farmaceutikë" me numër të referencës RN00012281 në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ka gjetur se ndër të tjerash në pikën 7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim janë kërkuar si në vijim edhe: "Kopjet e dëshmisë së punësimit të cilave u bashkëngjitet së paku njëra nga dëshmitë mbështetëse si në vijim: pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale (vërejtje: nuk

vlen vetëm vërtetimi dhe apo vetëm dokumenti mbështetës, është i nevojshëm ngarkimi në sistem i të dy llojeve të dokumenteve: vërtetimi si dëshmi kryesore dhe njëra nga pasqyrat si dëshmi mbështetëse); Kopjen e licencës për ushtrim të pavarur të veprimtarisë shëndetësore; Kopjet e dëshmisë së trajnimeve të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit. Njëra nga këto dokumente është e mjaftueshme; Certifikatë/vërtetim nga Gjykata ose nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës me të cilin dëshmohet se nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit; Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojën e kërkuar e punës, është në sektorin publik, atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati/ja me të cilin dëshmohet se ai/ajo nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L – 114 për Zyrtarët Publik. Nëse përvoja e punës e deklaruar është në: sektorin privat brenda apo jashtë vendit, në një OJQ brenda apo jashtë vendit apo angazhimi nga i cili rrjedhë përvoja e punës është ndonjë formë e marrëdhënies kontraktuale që nuk nënkupton marrëdhënie pune, atëherë është i nevojshëm një vetë deklaram i nënshkruar se ai/ajo, nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L – 114 për Zyrtarët Publik”, kurse ankuesi nuk e konteston një çështja të tillë, as mungesën e ngarkimit të dokumentacionit të kërkuar me rastin e aplikimit, por i njëjti pretendimin e mbështet vetëm mbi faktin e mungesës së njohjes me procedurat e rekrutimit përmes sistemit elektronik.

Duke marrë për bazë dispozitat Rregullore Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku me nenin 12 paragrafi 2 përcaktohet se kandidatët me rastin e aplikimit duhet të bashkëngjisin kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruara në aplikacion, ndërsa në nenin 15 paragrafi 3 përcaktohet se në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë, dhe mbi këtë bazë si dhe të konstatimeve të pasqyruara si më lartë, Kolegji i Këshillit konstatoi se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me rastin e refuzimit të aplikacionit të ankuesit përmes Vendimit të datës 03.10.2023 ka vepruar drejtë ngase ankuesi nuk ka plotësuar kërkesën e përcaktuar të konkursit të datës 09.08.2023 ngase nuk ka bashkëngjitur dëshmitë që lidhen me licencën e punës, dëshminë mbi përvojën e punës profesionale prej së paku 2 vite në fushën për të cilën zhvillohet përvoja e punës, certifikatën/vërtetimin e gjykatës përmes së cilës dëshmohet se ankuesi nuk i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale, vetë deklaramin që i njëjti nuk ka të shqiptuar masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, ndërsa pretendimi ankimor i ankuesit se i njëjti nuk ka qenë i familjarizuar me procedurat e aplikimit online është i pabazuar ngase normat e ligjit material këtë çështje e kanë përcaktuar qartë qysh në përmbajtjen e publikimit të konkursit, se të njëjtat dëshmi apo dokumente duhet të bashkëngjiten me rastin e aplikimit, dhe po ashtu konkursit ka qenë i shpallur me datë 09.08.2023 ndërsa afati për aplikim ka qenë nga data 08.09.2023 deri me datë 18.09.2023, nga rrjedh se ankuesi ka pasur kohë të mjaftueshme prej më shumë se një (1) muaj për tu përgatitur për aplikim.

Prandaj nga se u tha si më lartë në arsyetimin e këtij, Kolegji i Këshillit konstatoi se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 11.10.2023 përmes së cilit e kanë refuzuar të ankesën e brendshme të ankuesit të datës 04.10.2023, ndërsa kanë lënë në fuqi Vendimin e datës 03.10.2023 për refuzimin e aplikacionit të ankuesit ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e nenit nenin 12 paragrafi 2 dhe nenit 15 paragrafi 3 të Rregullore Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ngase ankuesi nuk kishte përmbushur kërkesat e përcaktuara të konkursit të datës 09.08.2023, respektivisht refuzimi i aplikacionit të ankuesit nuk prejjudikon faktin nëse ankuesi i ka poseduar dëshmitë e kërkuara sipas konkursit, mirëpo

vendimi në fjalë dëshmon konstatim të gjendjes faktike vetëm mbi bazën e aplikacionit të ankuesit të datës 08.09.2023 dhe dokumenteve të bashkangjitura me rastin e aplikimit, andaj nga se u tha si më lartë ankesa e ankuesit u refuzua sikurse në dispozitivin e këtij vendimi ndërsa akti i kontestuar përmes kësaj ankese mbetet në fuqi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në diapozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Ky vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1381/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

